



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izbórni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.158/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rustem Thaçi dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit AAK&PSD, me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së tendës (Shtandit) në hapësirë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 04.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet e bazuar ankesa e Anr.158/2019 e datës 01.10.2019, e paraqitur nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Koalicionit AAK&PSD, i shqiptohet gjobë në lartësi prej 2,200.00 euro (dymijë e dyqind), për shkak të vendosjes së tendës (Shtandit) në hapësirë publike, të cilën gjobë DETYROHET ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 01.10.2019, Lëvizja Vetëvendosje, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 01 Tetor 2019 rreth orës 13:20, në sheshin “Fadil Vata” në Suharekë, kanë vërejtur se Koalicioni AAK&PSD ka vendosur “TENDË- SHTAND”, me materiale zgjedhore ku ekspozohen disa fotografi të kandidatëve të saj dhe slogani 100% si slogan i këtij koalicioni, në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së, dhe Rregullën zgjedhore 13/2013 të KQZ-së. Si dëshmi ankesës i kanë bashkangjitur fotografitë në cilësi të provës materiale.

Në përgjigje në ankesë të datës 02.10.2019, Koalicioni AAK&PSD, thekson se kjo shtandë është bërë me leje përkatëse dhe se kanë marrë masa përmisuese duke e larguar materialin nga vendi ku ka qenë i vendosur ai. Si dëshmi kanë bashkangjitur fotografitë ku shihet largimi i posterave dhe shtandit-tendës nga vendi ku ka qenë i vendosur ai.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe shkresat e lëndës vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se tenda-shtandi me materiale zgjedhore dhe slogani i Koalicionit AAK&PSD dhe fotografi të kandidatëve për deputet nga ky Koalicion, janë të vendosur në hapësirat publike në sheshin “Fadil Vata” në Suharekë.

Nga dëshmitë e sipërcituara paneli në mënyrë të sigurt ka vërtetuar se Koalicioni AAK&PSD, ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët. Kjo për fakti se tendat dhe shtandet e vendosura në hapësirat publike, paraqesin

veprime të sanksionuara me dispozitën e nenit 33 pika b) e LZP-së, e cila përcakton “ Vendosi e njoftimeve, pllakateve dhe postereve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve”..

Paneli, vendimin e tij e ka mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, prandaj pretendimet në përgjigje në ankesë nuk u cilësuan me ndikim në meritat e lëndës.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalët, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se Koalicioni AAK&PSD, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me Rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur më fushatën zgjedhore.

Si rrethanë PZAP-i, mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësia për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tij ka deklaruar se kanë ndërmarrë veprime për evitimin e shkeljes duke i bashkangjitur përgjigjes në ankesë një fotografi ku shihet se është bërë heqja e tendës dhe materialeve zgjedhore dhe ka marre masa përmirësuese në bazë të nenit 120 par.1 , pika a të LZP-së. Ndërmarrja e masave përmirësuese nga ana e subjektit në fjalë ka ndikuar në uljen e gjobës së shqiptuar nga PZAP-i, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ndërmarrja e masave përmirësuese nga ana e subjektit në fjalë ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.158/2019 më datën 04.10.2019

Kryesues i Panelit
Fejzullah Rexhepi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118.par. 4 të LZP-së.